

Zoti Vullnet Karafilaj kryen detyrën e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit prej datës 17.10.2019. Ai ka filluar të punojë pranë KLSH-së në Mars 2015 dhe ka ushtruar funksione, Kryeauditues dhe Drejtor Departamenti.

Në periudhën 1997 – mars 2015 ai ka kryer detyrën Doganier (C2, C1), në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në këtë institucion ai ka qenë doganier vlerësues në doganat Rinas, Tiranë, Durrës.

Në periudhën korik 2018 – qershor 2019 z. Karafilaj ka ushtruar funksionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, ku detura kryesore ka qenë menaxhimi administrativ i të gjithë veprimtarisë së Drejtorive dhe Sektorëve sipas strukturës.

Zoti Karafilaj është diplomuar në qershor 1994, Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti Gjeologji – Miniera.

Në Qershor 2002 është diplomuar Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Në Mars 2011 ka kryer Master të Nivelit të Dytë në Shkencat Juridiko - Penale në Universitetin “Justiniani i I-rë”.

Ai gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në kongrese, konferenca, seminare dhe Workshop-e të organizuara nga INTOSAI/EUROSAI/OLACEFS në Slloveni, Ekuador, Kroaci, Portugali, Hungari, Turqi, etj.